



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04 5998 dt. 31 01 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **18.01.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 17.11.2022.
2. Draft Propozim i Planit të Veprimit për vitin 2023-2024 të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 me ndryshim-plotësimin.
3. Propozim Vendim për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë.
4. Raporti i performancës të Komunës së Drenasit për vitin 2021.
5. Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.
6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizua për vitin 2022
7. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për për Arsim Kulturë Rini dhe Sport. për vitin 2022.
8. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022.
9. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2022.
10. Raporti financiar Janar-Dhjetor 2022.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan unanimisht rendin e ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur Të dt. 17.11.2022.**

Arbër Halilaj, ndoshta që mbledhja u mbajt pa tekniken e mikrofonave, kemi pas diskutime mirëpo nuk janë paraqitur të gjitha, kërkoj që të keni kujdes tek procesverbalet.

Florentina Elezi-Veliu, edhe unë kam disa vërejtje sepse nuk u përpiluar si duhet ky procesverbal, ka mungesa të diskutimeve, është një përmbledhje shumë e shkurtër, edhe pse nuk ka qenë me incizime, votoj kundër.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ky është procesverbal, nuk është transkript, në procesverbal nxirën vetëm ato themeloret, nuk nxirret gjithë debati apo gjithë ato që i diskutoni, ju keni të drejt me kërkuar edhe transkript me bë, mirëpo tani është edhe incizimi mundeni me kërku edhe me pas për nevoja të juaja nuk keni të drejt me përdor për nevoja tjera, kështu që mënoj se procesverbali mundet me qenë edhe më i shkurt se sa ky që është.

Pasi që nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
05 vota (Për), 2 vota kundër, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës. **2. Draft Propozim i Planit të Veprimtë për vitin 2023-2024 të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 me ndryshim-plotësimin.**

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kjo është iniciativë e z.Bardhyl Mahmuti, ka kaluar në disa komuna, unë mendoj se duhet me pas një shenjë dhe me kujtu këto ngjarje, ne e kemi vendos në rend ditë ju ftojme me e votu.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **4. Raporti i performancës të Komunës së Drenasit për vitin 2021.**

Meqë nuk pati diskutime u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin nga pika pestë deri tek pika e nëntë të rendit të ditës: **Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete dhe Kthim. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizua për vitin 2022 Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për për Arsim Kulturë Rini dhe Sport. për vitin 2022. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2022.**

Meqë nuk pati diskutime u rekomanduan për kuvend këto pika të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Raporti financiar Janar-Dhjetor 2022.**

Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku, sa i përket raportit financiar Janar-Dhjetor 2022, mund të themi se si vit fiskal e kemi mbyll mirë sa i përket realizimit të hyrave dhe realizimit të buxhetit për vitin 2022, shpenzimi i buxhetit për vitin 2022 është 94.63 kemi dhënë një përqindje të përgjithshme, ka pas ndikim të dukshëm në realizimin e të hyrave, por kur të hyrave të realizuar për këtë vit i shtohen dhe të hyrat indirekte shihet se ka tejkalim të planit vjetor, shuma e planifikuar është 1,209,986,00 ndërsa shuma ku shtohen edhe të hyrat indirekte apo shuma prej 2,656,421,74 €, raportit tre mujor i gjobave dhe të gjykatave dhe gjobave të komunikacionit nuk është alokuar ende për periudhën 2022 dhe presim brenda muajit të alokohen.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Të ndryshme.**

Florentina Elezi-Veliu, duke pas parasysh se sa herë po bien shi po kemi problem me ujësjellës në Drenas, dashta me diskutu se çka mundemi të bëjmë, ju si komunë a keni mbajt ndonjë mbledhje apo keni mëndu ndonjë strategji se si mundemi me e përmirësua këtë problem bashkërisht edhe me ujësjellësin.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ju e keni pas në dëgjim krye shefat e kompanive rajonale të ujësjellësit dhe kompanisë se mbeturinave, është përgjegjësi e tyre, nuk kemi asnjë kërkesë prej tyre për ndihmë të veçante

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:30 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari